

VENDIM
Nr.230, datë 7.4.2010

PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSIVE TË INSTITUCIONEVE TË QEVERISJES
QENDRORE, PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 118 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 3 të nenit 1 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përgjegjësive të institucioneve të qeverisjes qendrore, për procedurat e kryerjes së pagesës së nëpunësve/punonjësve të secilit institucion.

2. Çdo institucion, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është përgjegjës për kalimin e pagës, në njëhën nga bankat e nivelit të dytë, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, përzgjedhur nga secili nëpunës/punonjës i institucionit, pavarësisht rregullimit të marrëdhënieve të punës me ligjet nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, apo nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

3. Referenca e nëpunësit/punonjësit për përzgjedhjen e bankës jepet pas plotësimit të një formulari standard, të përgatitur dhe të vënë në dispozicion nga strukturat e personelit, brenda çdo institucioni.

4. Formulari dorëzohet në strukturat e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e tërheqjes.

5. Formulari duhet të përmbajë të paktën të dhëna për:

a) gjenealogjën e nëpunësit/punonjësit;

b) emrin e bankës dhe llogarinë bankare, në rast se ekziston një e tillë;

c) nënshkrimin dhe datën e plotësimit të formularit.

6. Nëpunësi/punonjësi mund të përzgjedhë, si bankë të preferuar, bankën ku mund të ketë një llogari të hapur bankare ose një bankë tjetër. Në çdo rast, të dhënat për numrin e llogarisë bankare ekzistuese duhet të bëhen të qarta në formularin e plotësuar, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

7. Formularët i dërgohen zyrës së financës, përgjegjëse për përgatitjen e pagave.

8. Përgatitja e formularit për shoqëritë tregtare me kapital shtetëror bëhet nga institucionet, prej të cilave ato varen.

9. Strukturat e përcaktuara në këtë vendim përgatisin formularin përkatës për përzgjedhjen e bankës, brenda 2 (dy) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Ngarkohen institucionet e parashikuara në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ngarkohen ministrat, që kanë në varësi shoqëri tregtare, të nxjerrin urdhrat përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha